



ALEANCA PËR FËMIJËT SHQIPËRI



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

KARTA RAJONALE RAPORTUESE – QARKU FIER

“Buxheti për fëmijë” për vitin 2011



QARKU FIER

Eksperte Rajonale
Eridjona Kica

Lista e shkurtimeve

Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Fier
ACA	- Aleanca për Fëmijët në Shqipëri
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
NJDF	- Njësia për të Drejtat E fëmijëve
NJMF	- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
MASh	- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
DAR	- Drejtoria Arsimore Rajonale
ZA	- Zyra Arsimore
DShPSH	- Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore- Qarku Fier
MB	- Ministria e Brendshme
PAK	- Personat me aftësi të kufizuara
OBSH	- Organizata Botërore e Shëndetësisë
Co Plan	- Instituti për Zhvillimin e Habitatit
SNV	- Organizatë Jo Qeveritare Zhvillimi
EGUG II	- Qeveria e Hollandës – Programi i Zgjerimit
NOSA	- Rrjeti për Shoqëri të Hapur për Shqipërinë

I. Parathënie dhe falënderime

“Observatori për të Drejtat e Fëmijës” është një iniciativë ndërmjet UNICEF dhe “Aleanca për Fëmijët”, që ka ngritur mekanizmin për mbledhjen e informacionit, monitorimin dhe studimin e situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajoni. Zyra e Observatorit, harton raporte bazuar në realizimin e të drejtave të fëmijës me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke u mbështetur në analizën e 140 treguesve të ndryshëm. Në rajonin e Fierit, Observatori ushtron veprimtarinë e tij që në Shtator të vitit 2011.

Observatori për të drejtat e fëmijëve Fier ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh publikë dhe jopublikë. Observatori Fier ka ngritur rrugën e *bashkëpunimit me 57 aktorë të rëndësishëm*, si: Prefektura, qarku, bashkitë dhe komunat, institucionet shëndetësore, arsimore, të shërbimeve sociale, të policisë, të punësimit si edhe struktura të shoqërisë civile etj.

Arritjet në nivel lokal për vitin 2010 konsistojnë në kontributin e Observatorit Fier në mbledhjen e të dhënave, të cilat u përpunuan në një program të ri të pasqyrimin në formë elektronike të të dhënave të Observatorit (www.aca.org.al). Observatori për të drejtat e fëmijëve Fier ka marrë pjesë aktivisht dhe ka dhënë kontributin e tij të rëndësishëm si pjesë e grupit teknik për hartimin e Strategjisë rajonale për fëmijët 2013- 2015 Fier.

Përveç mbledhjes së treguesve të të drejtave të fëmijëve në sektorë të ndryshëm, si: arsim, shëndetësi, punësim, ndihmë ekonomike, pjesëmarrje të fëmijëve, Observatori ndërmori nismën e realizimit të një studimi rajonal lidhur me temën e buxhetimit të fëmijëve për vitin 2011.

Për realizimin e këtij studimi, falënderoj për bashkëpunimin institucional dhe mbështetjen e tyre aktorët e rëndësishëm vendorë, si: Këshilli i qarkut Fier (Drejtoria e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore- DShPSH), institucionet arsimore, shëndetësore, shërbimin social shtetëror zyrën rajonale Fier, zyrat rajonale të shërbimit kombëtar të punësimit. Një mirënjohje dhe falënderim i veçantë i shkon kryetarit të Bashkisë Fier, Z. Baftjar Zeqo, i cili ka dhënë një përkrahje të pakushtëzuar institucionale për Observatorin Fier. Falënderoj: Drejtorinë e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore- qarku Fier për kontributin në realizimin e këtij studimi (në veçanti Z. Astrit Hysi dhe Znj. Enerjeta Avrami), si edhe kryetarët e njësive vendore: Komuna Libofshë, Komuna Gradisht dhe Bashkia Ballsh, si edhe punonjësit e ndihmës ekonomike dhe politikave sociale të këtyre njësive, që kanë dhënë kontributin e tyre nëpërmjet informacioneve dhe nëpërmjet realizimit të fokus grupeve.

Një falënderim i veçantë i dedikohet UNICEF, që është mbështetja financiare për realizimin e këtij studimi, si edhe Znj. Suzana Sakiqi, kordinatorja kombëtare e Aleancës shqiptare për fëmijët në Shqipëri, e cila ka venë në jetë këtë projekt. Mbështetja më e rëndësishme humane dhe profesionale ka ardhur nga Znj. Elma Tershana (drejtoreshë e projektit) nga zyra qendrore e Observatorit për të drejtat e fëmijëve në Tiranë. Një falënderim shkon dhe për Znj. Mina Mata (Administratore Kombëtare për të dhënat), për mirëkuptimin dhe mbështetjen që ka dhënë gjatë realizimit të studimit.

Falënderime të përzemërta!

II.Hyrja

Studimi i buxhetimit për fëmijë është një nismë, e cila është realizuar në rajonin e Fierit paralelisht me hartimin e Strategjisë rajonale për fëmijët 2013- 2015, një pjesë e rëndësishme dhe delikate e së cilës është buxhetimi për fëmijët.

Qëllimi i studimit është analizimi dhe krahasimi i tendencave të buxhetimit për fëmijë në sektorët: arsim, shëndetësi, ndihmë ekonomike, pjesëmarrje nga fondet buxhetore të pushtetit qendror si edhe nga fondet buxhetore të qeverisjes vendore. Studimi analizon buxhetimin në vitin 2011 si edhe bën krahasimin e fondeve buxhetore në total dhe fondeve për fëmijët midis vitit 2011 dhe vitit paraardhës 2010, si edhe krahasimin ndërmjet tre rretheve Fier, Lushnje dhe Mallakastër. Çështja e buxhetimit është adresuar në këtë studim për shkak të specifikave të këtij rajoni, i cili në përbërje të tij ka shumë kategori vulnerable dhe të marginalizuara, si fëmijët romë, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët që i përkasin familjeve të varfra etj.

Buxhetimi është një çështje që kërkon vëmendje të veçantë, në mënyrë që fondet e alokuara nga pushteti qendror dhe të përpiluara nga pushteti vendor të jenë sa më konform nevojave dhe prioriteteve të këtij rajoni.

Ky studim është realizuar duke u bazuar në disa **prioritete dhe burime**, të cilat kryesisht janë:

- të dhënat cilësore për prioritetet e nevojave të fëmijëve si edhe rëndësisë që ata zënë ose jo në buxhetimin qendror dhe vendor, nëpërmjet fokus grupeve të realizuar në 2 bashki dhe 2 komuna të rajonit Fier;
- të dhënat sasiore nëpërmjet institucioneve përkatëse për fondet buxhetore të pushtetit qendror dhe pushtetit të qeverisjes vendore për vitin 2011 në rajonin Fier;
- të dhënat e fondeve buxhetore në total nga pushteti qendror për sektorët: arsim, shëndetësi, ndihmë ekonomike, aftësia e kufizuar, shpenzime personeli;
- llogaritja sipas koeficienteve dhe formulave të gatshme të buxhetit qendror për fëmijë në secilin sektorë;
- informacione në lidhje me fondet buxhetore të qeverisjes vendore për: arsim, qendra sociale, art kulturë dhe sport, për shpenzime personeli në njësitë vendore;
- llogaritja sipas koeficienteve dhe formulave të gatshme të buxhetit vendor për fëmijë në secilin sektorë;
- krahasimi i fondeve buxhetore në total dhe atyre për fëmijë midis vitit 2011 dhe vitit paraardhës 2010 në nivel rrethi dhe të granteve në nivel bashkie/ komune.

Ky studim i dedikohet një audience të gjerë, pasi gjetjet e këtij studimi i shërbejnë institucioneve arsimore, shëndetësore, të mbrojtjes sociale dhe njësite vendore. Nëpërmjet gjetjeve të këtij studimi, institucionet do të mund të reflektojnë mbi arsyet e mundshme që kanë influencuar në tendencën e uljes ose të ngritjes së fondeve buxhetore të pushtetit qendror dhe vendor, si dhe në përcaktimin e një buxheti që i përgjigjet nevojave të grupeve të fëmijëve në nevojë.

Buxhetimi është një çështje e pashmangshme dhe e rëndësishme njëkohësisht për të gjithë institucionet. Rezultatet e këtij studimi do i shërbejnë jo vetëm aktorëve të përfshirë në këtë studim, por të gjithë institucioneve. Rezultatet e këtij studimi do të mund të pasqyrojnë përfitimet dhe buxhetet që politikat e njësite vendore të Qarkut Fier vënë në dispozicion të realizimit dhe garantimit të mirëqenies së fëmijëve, e alokuar kjo në sektorë të veçantë. Institucionet përkatëse mund të reflektojnë edhe mbi tendencën e buxhetit për fëmijë në periudhën kohore të dy viteve.

Ky studim ka në fokus të tij si grup kryesor *fëmijët*, (mosha 0-18 vjeç). Qarku Fier në vitin 2011 numëron një popullsi prej 488,330 banorë¹, nga të cilët rrethi Fier ka edhe numrin më të lartë të banorëve, duke u pasuar nga rrethi Lushnje dhe në fund nga rrethi i Mallakastrës. Ndërsa numri i fëmijëve (mosha 0-18 vjeç), në qarkun e Fierit për vitin 2011 është 122,011 fëmijë, duke e renditur qarkun e Fierit në vendin e dytë në rang kombëtar me numrin më të lartë të fëmijëve, pas qarkut të Tiranës me 246,041 fëmijë². Numri i fëmijëve në qarkun Fier zë ¼ e popullsisë në vitin 2011, pra 25%. Përqindjen më të lartë të numrit të fëmijëve e zë rrethi Mallakastër me 28%, ndjekur nga rrethi Lushnje me 25% dhe rrethi Fier me 24%. Nëse do të krahasojmë tendencën e përqindjes së fëmijëve me vitin paraardhës, vërejmë një **ulje** (në vitin 2010 përqindja e fëmijëve në nivel rajonal në raport me popullsinë ishte 27%).

Arsyeja e përzgjedhjes së studimit të buxhetimit në rajonin Fier është se fëmijët zënë një numër të konsiderueshëm në qarkun Fier. Një fakt i tillë, duhet të shërbej për marrjen më shumë në konsideratë të realizimit të nevojave të fëmijëve, duke rritur shkallën e investimeve për këtë kategori dhe duke shtuar politikën në fokus të mirëqenies dhe interesit më të lartë të tyre. Problemet që ky studim do të adresojë, janë qasur në mënyrë të drejtë për drejtë me aktorët e përfshirë në këtë studim, të cilat kryesisht janë:

- 1) Buxheti qendror dhe vendor për çdo fëmijë është i mjaftueshëm për të plotësuar nevojat në rritje dhe prioritetet e fëmijëve, veçanërisht të grupeve më në nevojë?
- 2) Grantet e alokuara nga pushteti qendror në vitin 2011 janë më të larta në vlerë se të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor nëpërmjet taksave dhe tatimeve në po të njëjtin vit?

Përshkrimi i buxhetimit:

Hartimi i buxhetit realizohet mbi politika dhe programe të veçanta. Në këtë mënyrë buxheti i vitit 2011 është hartuar mbi bazë të ligjit nr 10 355 datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”. Buxheti lidhet me dokumente të ndryshëm strategjikë, si: buxheti me pjesëmarrje (për të cilin përpjekjet e para janë iniciuar nga Bashkia Fier), programi buxhetor për shërbimet e kujdesit parësor dhe publik, programi buxhetor i arsimit bazë, i mesëm i përgjithshëm dhe profesional.

Për realizimin e nevojave të fëmijëve, një kontribut të veçantë zënë jo vetëm fondet buxhetore të alokuara nga pushteti qendror, por edhe donatorë si: Banka Botërore (e cila nëpërmjet fondeve të saj ka investuar në disa fusha, duke ri-konstruktuar me parametra bashkëkohorë gjimnazin Besëlidhja në Bashkinë Ballsh).

Metodologjia

Për realizimin e studimit të buxhetimit në nivel rajonal, burimi i të dhënave ka konsistuar në metodologjinë:

- a) ***Desk review***, e cila përfshin rishikimin e dokumenteve, raporteve, ligjeve, studimeve kombëtare, disa prej të cilave janë:
 - Programi buxhetor i arsimit bazë, i mesëm i përgjithshëm dhe profesional;
 - Programi buxhetor për shërbimet e kujdesit parësor dhe publik;
 - Ligji nr 10 355 datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”;
 - Projekt buxheti 2011- 2013, Ministria e Financave;
 - Relacion i projekt buxhetit faktik 2011, Ministria e Financave;
 - Udhëzimi i zbatimit të buxhetit 2011;
 - Buxheti me pjesëmarrje, udhëzues për pushtetin vendor në Shqipëri.

¹ Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2012.

² Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2012.

b) Mbledhje informacioni në lidhje me buxhetimin nga pushteti qendror dhe vendor nga Degët e thesarit Fier, Lushnje dhe Mallakastër. (Në *Shtojca c* gjenden pyetjet e përdorura për mbledhjen e informacioneve).

c) Fokus grupet, - organizimi i këtyre takimeve u realizua gjatë muajit Dhjetor 2012 dhe u shtri në 2 bashki dhe 2 komuna (në bashkinë Fier, bashkinë Ballsh Mallakastër, komunën Libofshë Fier dhe komunën Gradisht Lushnje). Arsyeja e përzgjedhjes së këtyre njësive vendore është: niveli i përfaqësimit që kanë në nivel rajonal, numrin e lartë të fëmijëve si edhe për marrëdhëniet e mira institucionale. Nëpërmjet përzgjedhjes së këtyre njësive vendore, arrihet një shkallë përfaqësimi për të tre rrethet (Fier, Lushnje, Mallakastër).

Janë realizuar gjithsej 5 fokus grupe, me 5-7 pjesëtarë secili, me një shpërndarje gjeografike fshat- qytet, dhe me një balancim gjinor (femra dhe meshkuj). Kohëzgjatja e realizimit të një fokus grupi varioi nga 45-60 minuta. Pjesëmarrës në këto fokus grupe ishin:

- Punonjës të ekonomisë dhe financave pranë njësive vendore (bashki ose komunë);
- Punonjës social;
- Punonjës të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale;
- Punonjës të politikave sociale.

Instrumentet e përdorura për realizimin e fokus grupeve ishin pyetjet e hapura. Me punonjës të ekonomisë dhe financave u realizuan fokus grupe me 7 çështje, ndërsa për realizimin e fokus grupeve me punonjës social dhe punonjës të politikave sociale u realizuan fokus grupe me 6 pyetje të hapura (Në *Shtojca a, b* gjenden pyetjet e përdorura në fokus grupe). Për realizimin e këtyre fokus grupeve pjesëmarrja e aktorëve të interesuar paraqitet mjaft pozitive.

Gjatë kryerjes së studimit është garantuar *etika, konfidencialiteti dhe siguria* për përdorimin e të dhënave dhe materialeve për qëllime kërkimore. Para dhe gjatë kryerjes së fokus grupeve, titullarët e institucioneve dhe pjesëmarrësit janë bërë me dije, se të dhënat e mbledhura do të publikohen në nivel rajonal.

Limitet/ kufizimet e metodologjisë lidhen me afatin e shkurtër kohor për kryerjen e fokus grupeve, si edhe me mundësitë e kufizuara financiare që kushtëzuan në një numër të limituar të njësive vendore, që u bënë pjesë e këtij studimi nëpërmjet fokus grupeve. Të dhënat e mbledhura nga Degët e thesarit në të tre rrethet janë një burim i larmishëm informacioni, që pasqyrojnë gjendjen e fondeve buxhetore të pushtetit qendror dhe vendor. Megjithatë fokus grupet shpalosin një panoramë cilësore që zbërthejnë me shpjegime specifike situatën e shifrave. Ato tregojnë më tepër për investimet e realizuara, për pritshmërinë e prindërve dhe fëmijëve për realizimin e nevojave më thelbësore.

Pritshmëritë nga studimi lidhen me analizën krahasuese të fondeve buxhetore të pushtetit qendror dhe vendor, me tendencën e tyre, mbi reflektimin mbi nevojat prioritare për fonde më të mëdha buxhetore për fëmijët si edhe mbi vënien në fokus të agjendës se pushtetit lokal të buxhetimit për fëmijë.

III. Analiza e të dhënave

Procedura për analizën e të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave nëpërmjet teknikës *Desk review*, formularit të plotësuar në Degët e thesarit dhe komunikimit mes *fokus grupeve*, për përpunimin e të dhënave u përdor një *analizë përshkruese (deskriptive) dhe krahasuese* ndërmjet fondeve buxhetore në total dhe fondet e vëna në dispozicion për fëmijë në nivelet përkatëse:

- pushtetit qendror;
- pushtetit vendor;
- vitit 2011 dhe vitit paraardhës 2010.

Të drejtat e fëmijëve në vëmendjen lokale

Të drejtat e fëmijëve janë ligjëruar dhe mbrohen sipas Ligjit numër 10 347, datë 4. 11. 2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, i cili i vjen në mbrojtje të gjithë fëmijëve me shtetësi shqiptare, që ndodhen brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Të drejtat e fëmijëve, jo vetëm që duhet të ekzistojnë në parim, por duhet të marrin edhe mbështetjen e duhur nga mekanizmat institucional në nivel qendror dhe vendor, të përcaktuara nga ligji³. Ndërkohë mekanizmi institucional vendor në qarkun Fier, i ngritur tashmë në nivel qarku është Njësia për të drejtat e fëmijëve (NJDF), e cila është ngritur në fund të vitit 2011. Ndërsa ngritja e Njesisë për mbrojtjen e fëmijëve (NJMF) është një proces edhe më kompleks, pasi duhet të shtrihet deri në nivel komune. Në rajonin Fier, NJMF – gjenden në 10 njësitë vendore:

- Bashkia Fier;
- Bashkia Roskovec;
- Komuna Dërmenas;
- Komuna Qendër;
- Komuna Levan;
- Komuna Ruzhdie;
- Bashkia Lushnje;
- Bashkia Ballsh;
- Komuna Greshicë;
- Komuna Hekal.

Këto mekanizma të ngritura me iniciativën e bashkive/ komunave, zënë 23.8% të njësive vendore në nivel rajonal. Në të ardhmen synohet që të rritet numri i tyre deri në mbulimin e plotë të Qarkut Fier. Ato bashkëpunojnë edhe me institucionet e tjera publike si edhe me aktorët e shoqërisë civile me fokusin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

Në shtator të vitit 2012, në saj të partnerit UNICEF, Qarku Fier nisi hartimin e Strategjisë rajonale për fëmijët 2013- 2015, e cila do të pasqyroj situatën reale të nevojave dhe zbatimit të të drejtave të fëmijëve sipas sektorëve specifikë.

Aksesi ndaj buxhetimit

Republika e Shqipërisë pas ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, ka ndërmarrë shumë nisma për realizimin e reformave gjithëpërfshirëse me synimin e përforsimit të mirëqenies dhe interesit më të lartë të fëmijës. Qeveria në çdo fundvit harton dhe miraton buxhetin për vitin pasardhës, i cili është i specifikuar në zëra të veçantë. Përllogaritja e buxhetit që shkon për fëmijët është kompleks dhe realizohet në saj të formulave të gatshme, të koeficienteve duke u bazuar në Institucionet qendrore dhe programe buxhetore përkatëse:

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës me programet buxhetore “Arsimi Bazë” dhe “Arsimi i Mesëm i përgjithshëm dhe profesional”;
- Ministria e Shëndetësisë, me programet buxhetore “Shërbimet e kujdesit parësor” dhe “Shërbimet e kujdesit publik”;
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me programet buxhetore : “Mbrojtja sociale” dhe “Shanset e barabarta”;
- Zëri “Shpenzime buxhetore për personelin” për të gjithë buxhetin qendror.

Gjithashtu për përllogaritjen e buxhetit për fëmijë, janë analizuar fondet buxhetore të qeverisjes vendore për arsim dhe shpenzimet për personelin. Për të përcaktuar buxhetin për fëmijë në rajonin e Fierit, krahas informacionit mbi fondet buxhetore të buxhetit qendror dhe

³ OBSH (2001), Deklaratë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës.

vendor, përlogaritet numri total i popullsisë së Qarkut Fier dhe rretheve Fier, Lushnjë dhe Mallakastër si dhe numri i familjeve dhe i fëmijëve. Me anë të përlogaritjes së këtyre treguesve, pasi vendosen koeficientet e duhur, përlogaritët buxheti për çdo fëmijë.

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten të dhëna demografike në qarkun Fier për vitin 2011:

Tabela 1: Numri i fëmijëve dhe raporti me numrin total të popullsisë dhe familjet për vitin 2011 për Qarkun Fier.

Burimi: Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2012.

	Nr.fëmijëve	Nr.popu llsisë	Nr.fëmijëve/Nr .popullsisë (%)	Nr.familjeve	Nr.fëmijëve/Nr. familjeve
A	B	C	d=b/c	E	f=b/e
Qarku Fier	122 011	488 330	24.98%	122 991	99.2%
Fier	65 158	266 669	24.43%	66 907	97.38%
Lushnje	44 754	178 692	25.04%	45 217	98.97%
Mallakastër	12 099	42 969	28.15%	10 867	111.33%

3.1 Buxheti qendror

3.1 a) Shpenzimet buxhetore qendrore për zhvillim dhe arsim

Shpenzimet buxhetore për arsimin parauniversitar nga pushteti qendror, janë fonde nga të cilat fëmijët përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi përfshin shpenzime korrente dhe investime në institucione ku përfitues janë fëmijët.

Në tabelë pasqyrohen shpenzimet korrente dhe investimet për fëmijët në vitin 2011:

Tabela 2: Buxheti për vitin 2011 për arsimin parauniversitar për Qarkun Fier, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), DAR Fier, ZA Lushnje dhe ZA Mallakastër.

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr.fëmijëve në shkolla	Buxheti fëmijë (000 lekë)
A	b	C	d=b+c	E	f=d/e
Qarku Fier	2 901 485	100 613	3 002 098	54 252	55.336
Fier	1 425 180	33 593	1 458 773	23 427	62.268
Lushnje	1 176 797	24 609	1 201 406	26 461	45.402
Mallakastër	299 508	42 411	341 919	4 364	78.349

Krahasuar me vitin 2010 ky buxhet në total ka **ardhur në ulje** (nga 3 146 021 000 lekë në vitin 2010 në 3 002 098 000 lekë në vitin 2011), gjithashtu edhe për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve në shkolla (nga 51 819 fëmijë në vitin 2010 në 54 252 fëmijë në vitin 2011), rezulton se buxheti për fëmijë ka ardhur **duke u ulur** (nga 60 711 lekë në vitin 2010 në 55 336 lekë në vitin 2011).

Në këtë mënyrë, në kuadër të investimeve përgjatë vitit 2010 MASH ka qenë investues në:⁴


- Ndërtimin e shkollës së mesme Cakran (Fier);
- Ndërtimin e shkollës 9-vjeçare Mbrostar (Fier);
- Shtesën e shkollës së mesme Zharrëz (Fier);
- Ndërtimin e shkollës së mesme Ballsh (Mallakastër);
- Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare Hekal (Mallakastër).

Ndërkohë, në vitin 2011 MASH ka qenë investues në:

⁴ Prefekti i Qarkut Fier “Të dhëna mbi realizimin e investimeve në njësitë vendore, 2010-2011”.

- Ndërtimin e shkollës në Topojë (Fier);
- Ndërtimin e shkollës së mesme Ballsh (Mallakastër).


Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ulja e buxhetit në total në arsimin parauniversitar nga viti 2010 në vitin 2011 në qarkun Fier:



Grafikë 1: Buxheti qendror për fëmijë në arsimin parauniversitar 2011, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), Dhjetor 2012.

Ndërsa paraqitja e buxhetit për fëmijë në arsimin parauniversitar në vitin 2011 ndërmjet 3 rretheve, jepet nëpërmjet grafikut:



Grafikë 2: Buxheti qendror për fëmijë në arsimin parauniversitar 2011, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), Dhjetor 2012.

Nga analiza e buxhetit total qendror në nivel rrethi në sektorin e arsimit parauniversitar, rezulton se fondet në total janë më të larta në rrethin Fier dhe më të ulëta në rrethin Mallakastër, megjithatë në raport me numrin e fëmijëve në shkolla rezulton se **rrethi Mallakastër ka një buxhet më të lartë për fëmijë në arsimin parauniversitar** në vitin 2011 me 78 349 lekë, ndjekur nga rrethi Fier e në fund nga rrethi Lushnje.

Një gjë e tillë reflektohet në përmirësimin e cilësisë infrastrukurore në bashkinë Ballsh. Nga ndërtimet dhe rikonstruksionet e shkollave fëmijët kanë përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë, por gjithashtu ata kanë përfituar edhe nga ndërtimi i rrugëve. Bashkia Ballsh është një ndër bashkitë që ka në rregull rikonstruksionin dhe mbarëvajtjen e shkollave.

3.1 b) Shpenzimet buxhetore qendrore për kujdesin shëndetësor

Shpenzimet në sektorin e shëndetësisë janë fonde nga të cilat fëmijët nuk përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndaj përlllogaritja e tyre bëhet në bazë të koeficienteve. Në fillim përlllogaritjet financimi i sistemit shëndetësor për të gjithë popullsinë për të përcaktuar pjesën që shkon drejtë për drejtë për fëmijët.


Në tabelën e mëposhtme, paraqitet buxheti qendror për vitin 2011 për sektorin e shëndetësinë në Qarkun Fier:

Tabela 3: Buxheti qendror për vitin 2011 për shëndetësinë në Qarkun Fier, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), Dhjetor 2012.

	Shpenzi me korrente (000 lekë)	Investi me (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr.fëmijë ve/ Nr.popullsisë(%)	Buxheti për fëmijë në total (000 lekë)	Nr.i fëmijëve	Buxheti për çdo fëmijë (000 lekë)
A	B	C	d=b+c	e	f=d*e	G	i=f/g
Qarku Fier	637 249	11 243	648 492	25%	16 212 300	122 011	132.875
Fier	295 008	5 211	300 219	24.43%	7 334 350	65 158	112.562
Lushnje	292 386	5 232	297 618	25.04%	7 452 354	44 754	166.518
Mallakastër	49 855	800	50 655	28.15%	1 425 938	12 099	117.855

Krahasuar me vitin 2010, buxheti për fëmijë qendror në sektorin e shëndetësisë ka arritur **në rritje** në nivel qarku. Kjo justifikohet jo me rritjen e buxhetit në total në sektorin e shëndetësisë, por me uljen e numrit të fëmijëve në nivel qarku nga 27% në vitin 2010 në 25% në vitin 2011. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet buxheti për fëmijë në nivel qarku dhe rrethi:



Grafikë 3: Buxheti qendror për fëmijë në sektorin e shëndetësisë 2011, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), Dhjetor 2012.

Fondet buxhetore qendrore në shëndetësi evidentohen në shifër më të lartë në rrethin Fier me 300 219 000 lekë, më pas në rrethin Lushnje dhe në fund në rrethin Mallakastër. Megjithatë për shkak të numrit më të lartë të fëmijëve në rrethin Fier, rezulton se buxheti për fëmijë paraqitet **më i lartë në rrethin Lushnje**, më pas në rrethin Mallakastër dhe më i ulët në rrethin Fier. Një buxhet për fëmijët në këto raporte reflektohet edhe në një shkallë më të ulët të vdekshmërisë foshnjore 0-1 vjeç (7 në rrethin Lushnje dhe 12 në rrethin Fier).

3.1 c) Shpenzimet publike në sektorin e mbrojtjes sociale dhe tendenca e tyre

Fëmijët që i përkasin familjeve në nevojë dhe që janë përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, janë një kategori që përfiton nga ky buxhet. Në këtë fond buxhetor nuk përfshihen të gjithë familjet në gjendje të vështirë ekonomike me fëmijë 0-18 vjeç në rajonin e Fierit, por vetëm fëmijët të cilët bëjnë pjesë në familjet përfituese.

Në sektorin e mbrojtjes sociale, shpenzimet publike janë shumë të rëndësishme, pasi prekin një masë të ndjeshme të popullsisë. Shpenzimet publike në sektorin e mbrojtjes sociale prekin skemën e ndihmës ekonomike, përfituese të së cilës janë familjet e varfëra. Gjithashtu ky

sektorë prek edhe personat me aftësi të kufizuara, të cilët përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten fondet buxhetore të alokuara nga pushteti qendror për sektorin e politikave sociale në Qarkun Fier:

Tabela 4: Fondet buxhetore të alokuara nga MPÇSSHB për politikat sociale, Qarku Fier.

Burimi: Shërbimi Social shtetëror, zyra rajonale Fier.

	Ndihma ekonomike (000 lekë)	Nr.familjeve e përfituese	Nr.personave në këto familje	Nr.fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijë në total (000 lekë)	Buxheti për çdo fëmijë(000 lekë)
a	b	C	$d=c*4.2$	$e=c*2.2$	$f=(b/d)*e$	$g=f/e$
Qarku Fier	167 754	2 969	17 531	12 469	119 315	9.568
Fier	85 902	1 452	6 098	6 531	92 001	14.086
Lushnje	54 152	993	4 170	2 184	28 361	12.986
Mallakastër	27 700	524	2 200	1 152	14 504	12.590


Fondet buxhetore të alokuara nga MPÇSSHB për politikat sociale në qarkun Fier rezultojnë se në vitin 2011 **buxheti për fëmijë është më i lartë në rrethin Fier** dhe më i ulët në rrethin Mallakastër. Arsyeja kryesore konsiston në faktin se rrethi Fier ka më shumë njësi vendore, një numër më të lartë të popullsisë, ndërsa rrethi Mallakastër ka numrin më të ulët të njërive vendore.

Buxheti në tërësi është i ndarë në lidhje me nevojat që grupe të caktuara individësh paraqesin (për familjet në nevojë që marrin ndihmë ekonomike, për fëmijët me aftësi të kufizuara). Në këtë mënyrë buxheti është i ndarë për kategoritë:

- Ndihmë ekonomike;
- Paaftësi (mendore, fizike);
- Paraplegjikë dhe tetraplegjikë;
- Verbëria dhe kujdestarët e tyre;
- Invalidët e punës.

Në bashkinë Ballsh, pjesa më e madhe e buxhetit i shpërndahet paraplegjikëve, pavarësisht se janë më të pakët në numër (27 është numri i tyre ndërsa fondi për ta është rreth 1 milion lekë në muaj).

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet buxheti për fëmijë për Ndihmën ekonomike në vitin 2011, në nivel rrethi dhe qarku:



Grafikë 4: Buxheti qendror për fëmijë për Ndihmën ekonomike 2011, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), Dhjetor 2012.


Fondi qendror për PAK në total ka ardhur dukshëm më i ulët (në vitin 2010 ishte 185 280 000 lekë ndërsa në vitin 2011 është 128 762 000 lekë), për rrjedhojë dhe **buxheti për fëmijët me nevoja të veçanta ka ardhur në ulje** nga viti paraardhës (nga 22 523 lekë në vitin 2010 në 15 888 lekë në vitin 2011).

Tabela 5: Fondi i ndihmës për PAK

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, zyra rajonale Fier.

	Ndihma për PAK total (000 lekë)	Nr. përfituesve total	Nr.i fëmijëve përfitues	Fondi për fëmijët (000 lekë)	Buxheti për fëmijë (000 lekë)
A	B	C	D	e=(b*d)/c	f=e/d
Qarku Fier	128 762	8 104	2 457	39 038.528	15.888
Fier	68 770	4 611	1 520	22 669.789	14.913
Lushnje	40 049	2 743	737	10 760.522	14.599
Mallakastër	19 943	750	200	5 318.133	26.59

Në grafikun e mëposhtëm, paraqitet raporti midis tre rretheve dhe qarkut Fier në lidhje me buxhetin qendror të ndihmës për aftësinë e kufizuar:



Grafikë 5: Buxheti qendror për fëmijë i Ndihmës për PAK 2011, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), Dhjetor 2012.


Në nivel rrethi fondi për PAK në total është **më i lartë në rrethin Fier, e më i ulët në rrethin Mallakastër**, megjithatë për shkak të numrit të lartë të PAK përfitues në rrethin Fier rezulton se **buxheti për fëmijë është më i lartë në rrethin Mallakastër**. Pra ndonëse në rrethin Fier numri i PAK është dukshëm më i lartë (4 611 në rrethin Fier dhe 2 743 në rrethin Lushnje), fondet e alokuara nga pushteti qendror janë më të ulëta.

Tabela 6: Ndarja e buxhetit qendror sipas sektorëve në total dhe për çdo fëmijë për Qarkun e Fierit për vitin 2011, (në 000 lekë).

Burimi: Përlllogaritja nga Observatori Fier mbi treguesit më sipër.

	Spektori i arsimit parauniversitar		Spektori i shëndetësisë		Politika e mbrojtjes sociale (NE+ PAK)		Totali (000 lekë)	
	Total	Për/fëmijë	Total	Për/fëmijë	Total	Për/fëmijë	Total	Për/fëmijë
Qarku Fier	3002098	55.336	648492	132.875	296516	25.456	3947106	213.667
Fier	1458773	62.268	300219	112.562	154672	28.999	1913664	203.829
Lu	1201406	45.402	297618	166.518	94201	27.585	1593225	239.505
Mk	341919	78.349	50655	117.855	47643	39.18	440217	235.384


Më poshtë paraqitet grafikisht raport i **buxhetit qendror në total** sipas sektorëve: arsim parauniversitar, shëndetësi dhe mbrojtje sociale.



Grafikë 6: Ndarja e buxhetit qendror në total për sektorët: arsim parauniversitar, shëndetësi, mbrojtje sociale për vitin 2011, (në 000 lekë).

Burimi: Përlllogaritja nga Observatori Fier mbi treguesit më sipër.

Më poshtë paraqitet grafikisht raport i **buxhetit qendror për fëmijë** sipas sektorëve: arsim parauniversitar, shëndetësi dhe mbrojtje sociale.



Grafikë 7: Ndarja e buxhetit qendror për fëmijë në sektorët: arsim parauniversitar, shëndetësi, mbrojtje sociale për vitin 2011, (në 000 lekë).

Burimi: Përlllogaritja nga Observatori Fier mbi treguesit më sipër.

Në bazë të një analize interpretuese të tabelave dhe grafikëve përmbledhës, vërehet se fondet më të larta buxhetore në total nga pushteti qendror janë alokuar për sektorin e arsimit, më pas për sektorin e shëndetësisë dhe në fund për mbrojtjen sociale. Ndërsa nga përlllogaritja e këtyre fondeve buxhetore për fëmijë nga pushteti qendror rezulton se ato janë më të larta në sektorin e shëndetësisë, më pas për sektorin e arsimit dhe në fund për mbrojtjen sociale.

3.2 Buxheti vendor/ lokal, -Buxheti i qeverisjes lokale për fëmijët

Në ndryshim nga pushteti qendror, pushteti lokal ka përparësi veprimi për mbrojtjen dhe përkujdesin për shtresat në nevojë si edhe për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve, për shkak të

njohjes më nga afër të nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve që i shërben. Përsa i përket shpenzimeve që janë të miratuara në buxhetin e qeverisjes vendore mund të përmendim: Shpenzimet për funksionet e veta si dhe shpenzimet për funksionet e deleguara.

3.2 a) Shpenzimet buxhetore vendore për zhvillim dhe arsim

Tabela 7: Buxheti vendor për fëmijët në arsimin parauniversitar për vitin 2011, (në 000 lekë)

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), Dhjetor 2012.

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr. i fëmijëve në shkolla	Buxheti për fëmijë (000 lekë)
A	B	C	d= b+c	E	f= d/e
Qarku Fier	2 605 008.224	6 692.412	2 611 700.636	54 252	48.140
Fier	1 419 508.168	3 719.352	1 423 227.520	23 427	60.751
Lushnje	1 171 795.418	2 973.060	1 174 768.478	26 461	44.396
Mallakastër	13 704.638	-	13 704.638	4 364	3.140

Buxheti vendor për fëmijë në arsimin parauniversitar ka ardhur **në rritje** nga viti paraardhës (nga 26 855 lekë në vitin 2010 në vlerën 48 140 lekë për fëmijë në vitin 2011). Vlerën më të lartë të buxhetit vendor për fëmijë në arsimin parauniversitar e ka rrethi Fier me 60 751 lekë dhe më të ulët rrethi Mallakastër me 3 140 lekë. Buxheti më i lartë në rrethin Fier, reflekton një shkallë më të lartë të investimeve në shkolla, në rikonstruksionin e tyre.

Ulja e fondeve të pushtetit qendror ka shtuar iniciativën e vet pushtetit vendor për të kontribuar në mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e tyre. Në këtë mënyrë përgjatë vitit 2011 në Komunën Gradisht në rrethin Lushnje është rikonstruksionuar shkolla e mesme në fshatin Këmishtaj (dritaret), shkolla në fshatin Spolatë (rregullimi i çatave) si edhe shkolla në fshatin Babunjë.

Gjithashtu përgjatë vitit 2011 është realizuar një studim për rikonstruksionin e shkollës Këmishtaj (17 milionë lekë) në këtë komunë, preventivi i të cilit është dërguar në Ministri, por nuk është miratuar ende.

3.2 b) Shpenzimet buxhetore vendore për shpenzime personeli

Tabela 8: Buxheti vendor për fëmijë për shpenzime personeli për vitin 2011 në rrethin Fier, (në 000 lekë).

Burimi: Buletini Statistikor i Drejtorisë së Statistikës Fier, Janar 2013.

Vitet	Shpenzim e personeli (000 lekë)	Nr. i punonjësve e buxhetorë	Nr. i familjeve	Nr. i personave në këto familje	Nr. i fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijët (000 lekë)	Buxheti për çdo fëmijë (000 lekë)
A	b	C	d=c/1.5	e=d*4.2	f= d*2.2	g= (b/e)*f	h=g/f
2010	2 450 471	4 673	3115	13 083	6 853	1 283 580	187.301
2011	2 541 606	4 718	3 145	13 210	6 919	1 331 216	192.400

Buxheti vendor për çdo fëmijë për shpenzime personeli në rrethin Fier ka ardhur **në ulje** në krahasim me vitin 2010 (në të cilin ishte 187 301 lekë, ndërsa në vitin 2011 ka arritur në 192 400 lekë). Një ulje e tillë e vlerës së tij ndikon në mënyrë të tërthortë në plotësimin e nevojave të fëmijëve.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet ndarja e buxhetit vendor në total dhe për fëmijë, sipas sektorëve:

- arsimit parauniversitar;
- shpenzimet e personelit.

Përlllogaritja e këtij treguesi është realizuar në sektorin e arsimit parauniversitar si edhe në shpenzimet e personelit nga ana e pushtetit vendor. Buxheti vendor është përlllogaritur në total dhe i specifikuar për fëmijët.

Tabela 9: Ndarja e buxhetit vendor sipas sektorëve në total dhe për çdo fëmijë për Qarkun e Fierit për vitin 2011, (Në 000 lekë).

Burimi: Përlllogaritja nga Observatori Fier mbi treguesit më sipër.

	Sektori i arsimit parauniversitar		Shpenzime personeli		Totali (000 lekë)	
	Total	Për/fëmijë	Total	Për/fëmijë	Total	Për/fëmijë
Qarku Fier	2611700.636	48.140				
Fier	1423227.520	60.751	2541606	192.400	3964833.520	253.151
Lushnje	1174768.478	44.396				
Mk	13704.638	3.140				

Buxheti vendor total në rrethin Fier për vitin 2011 ka qenë 3 964 833 000 lekë, ndërsa për fëmijë 253 151 lekë.

Tabela 10: Shpenzimet publike totale për fëmijët për vitin 2011 në rrethin Fier, (në 000 lekë).

Burimi: Përlllogaritja nga Observatori Fier mbi treguesit më sipër.

	BQ+ BV për fëmijë (000 lekë)	Numri i fëmijëve (0-18 vjeç)	Buxhet për fëmijë (000 lekë)
A	B	C	d= (b/c)
Fier	5 878 497	65 158	90.219

Buxheti për fëmijë në rrethin Fier është 90 219 lekë. Pjesën më të lartë të buxhetit e zë ai vendor me 253 151 lekë për çdo fëmijë, në raport me buxhetin qendror me 203 892 lekë për çdo fëmijë.

Raporti i granteve qendrore dhe të ardhurave vendore në qarkun Fier

Nga viti 2010 në vitin 2011 totali i granteve dhe të ardhurave ka **ardhur në rritje**. Në vitin 2011 rritja më e ndjeshme është evidentuar tek të ardhurat (taksat dhe tatimet) e mbledhura nga pushteti vendor. Ndërkohë granti ka ardhur duke u ulur nga viti 2010 në vitin 2011.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet kjo lidhje:


Tabela 11: Granti dhe të ardhurat në nivel qarku për vitet 2010- 2012, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), Dhjetor 2012.

Viti	Grant	Të ardhura	Totali
2010	1 035 769	975 405	2 011 174
2011	1 034 522	1 195 964	2 230 486
2012	1 044 098	990 375	2 034 473

Të dhënat jepen në nivel rrethi dhe në nivel rajonal. Në nivel qarku, të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë më të larta sesa grantet e shpërndara nga pushteti qendror. Raportet më pozitive në këtë aspekt i paraqet rrethi Fier, më pas rrethi Mallakastër. Ndërkohë rrethi Lushnje paraqet një situatë të kundërt, në të cilën grantet e pushtetit qendror janë në vlerë më të lartë nga të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor.

Grantet e alokuara nga pushteti qendror dhe të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor përgjatë vitit 2011, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



Grafikë 8: Raporti i granteve qendrore dhe të ardhurave vendore në qarkun Fier për vitin 2011, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Fier, Lushnje dhe Mallakastër), Dhjetor 2012.

Buxhetimi me pjesëmarrje

Buxhetimi me pjesëmarrje të gjerë është një mekanizëm, i cili u mundëson qytetarëve që të marrin pjesë në vendimmarrje në menaxhimin e të gjitha burimeve, ose të një pjese aktive të financave publike të pushtetit lokal. Buxhetimi me pjesëmarrje ka për qëllim ngritjen e transparencës, përgjegjësinë dhe përfshirjen sociale në qeverisje.

Buxhetimi me pjesëmarrje është një trajtim i ri që sjell komunitetet lokale më afër procesit të vendimmarrjes lidhur me buxhetin publik. Kjo praktikë e re financiare ka potencialin që të rrisë pjesëmarrjen e zërit të qytetarëve përsa i përket vendimmarrjes rreth buxhetit si dhe për të ndihmuar qeverinë për të përmirësuar transparencën, efikasitetin, dhe përgjegjësinë mbi buxhetin.⁵

Buxhetimi me pjesëmarrje- modeli i Bashkisë Fier

Buxhetimi me pjesëmarrje u fillua në Bashkinë e Fierit në vitin 2007 duke u paraprirë nga një periudhë 3-vjeçare gjatë së cilës u hartua Strategjia e Zhvillimit të Qytetit të Fierit.

⁵ Buxhetimi me pjesëmarrje udhëzues për pushtetin vendor në Shqipëri (2006), Ekipi i Zhvillimit Social Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

Metodologjia e buxhetimit me pjesëmarrje u hartua nga Banka Botërore dhe u përshtat në kontekstin e Fierit nga Co-Plan dhe Bashkia e Fierit. Mbështetja financiare u dha nga:

- Qeveria e Hollandës nëpërmjet EGUG II – Programi i Zgjerimit;
- NOSA, Rrjeti për Shoqëri të Hapur për Shqipërinë.

Hapat e ndjekur:

- 1) *U ngrit grupi i punës* së buxhetimit me pjesëmarrje pranë Bashkisë.
- 2) U caktuan *lehtësues*: SNV Fier dhe Agjencia e Zhvillimit Rajonal të Fierit.
- 3) *Pjesëmarrës të shoqërisë civile*: organizata jo-qeveritare Dyert e së Ardhmes dhe Forumi Rinor i Fierit.
- 4) *Bashkëpunimi institucional* u realizua nëpërmjet nënshkrimit të një Memorandumi Mirëkuptimi. Bashkia e Fierit e konsideron buxhetimin me pjesëmarrje si një metodë jashtëzakonisht demokratike të qeverisjes, që synon ofrimin e zgjidhjeve për shumë çështje të ngritura nga qytetarët dhe përcaktimin e një kuadri më të madh për Strategjinë e Zhvillimit të Qytetit të Fierit.
- 5) *Motoja e prezantimit të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje për qytetarët e Fierit*: “Merrni pjesë, diskutoni dhe le të vendosim së bashku”.
- 6) *Mjetet ndërgjegjësuese*: postera, fletëpalosje, njoftime në TV etj.
- 7) *Fondi në dispozicion* për buxhetimin me pjesëmarrje: 50 milionë lekë për buxhetin total vjetor të bashkisë. Ky fond u caktua nga këshilli bashkiak, organi më i lartë vendimmarrës në Fier dhe përbënte ¼ e fondit të bashkisë për investimet që vijnë nga të ardhurat e vetë bashkisë.
- 8) *Takimet me qytetarët* u konceptuan në dy raunde:
 - raundi i parë: informimi i qytetarëve të Fierit rreth buxhetimit me pjesëmarrje;
 - raundi i dytë: evidentimi dhe përzgjedhja e përparësive për investime.
- 9) *Mbledhja e Këshillit të buxhetimit me pjesëmarrje*: u realizua në nëntor të vitit 2007. Këshilli miratoi rregulloren e brendshme (statutin) dhe diskutoi për kriteret që duhet të përdoren për vlerësimin e secilit projekt, të cilat ishin:
 - Kostoja e investimit;
 - Numri i përfituesve të drejtpërdrejtë dhe jo-drejtpërdrejtë;
 - Përputhshmëria me Strategjinë e Zhvillimit të Qytetit;
 - Cilësia e infrastrukturës ekzistuese në atë zonë, etj.
- 10) *Rezultati*: U përzgjedhën 10 projekte për t’u financuar nga buxheti vjetor i bashkisë. Këshilli i buxhetimit me pjesëmarrje monitoron zbatimin e punimeve civile dhe raporton në bashki në rast të ndonjë parregullsie.

Procesi i buxhetimit me pjesëmarrje është një mekanizëm që garanton përgjegjshmërinë e qeverisë ndaj qytetarëve dhe veçanërisht ndaj grupeve të përjashtuara të komunitetit. Buxhetimi me pjesëmarrje mund të konsiderohet si një nga mjetet që do të forcojë edhe më shumë procesin e duhur të decentralizimit në Shqipëri.

IV. Gjetjet dhe konkluzionet

- **Granti në nivel qarku** nga pushteti qendror për vitin 2011, ka ardhur *në ulje* (nga 1 035 769 000 lekë në vitin 2010 në 1 034 522 000 lekë në vitin 2011). Ndërsa në nivel rrethi, evidentohet se granti nga pushteti qendror ka ardhur *në ulje në rrethin Fier* (nga 553 863 000 lekë në 548 165 000 lekë). Granti ka ardhur *në rritje në rrethin Lushnje* (368 125 000 lekë në 371 851 000 lekë), gjithashtu granti ka ardhur *në rritje në rrethin Mallakastër* (nga 113 781 000 lekë në 114 506 000 lekë).
- **Të ardhurat në nivel qarku** nga pushteti vendor për vitin 2011, ka ardhur *në rritje* (nga 975 405 000 lekë në vitin 2010 në 1 195 964 000 lekë në vitin 2011). Ndërsa në nivel rrethi, evidentohet se të ardhurat nga pushteti vendor kanë ardhur *në rritje në rrethin Fier* (nga 565 611 000 lekë në 725 865 000 lekë). Gjithashtu të ardhurat nga pushteti vendor kanë ardhur *në rritje në rrethin Mallakastër* (nga 84 707 000 lekë në

146 171 000 lekë). Të ardhurat kanë ardhur *në ulje në rrethin Lushnje* (nga 325 087 000 lekë në 323 928 000 lekë).

- **Buxhetimi me pjesëmarrje** është i detyruar me ligj. Bashkia Fier e ka ndërmarrë këtë nismë, duke e finalizuar suksesshëm në vitin 2007, duke shërbyer në këtë mënyrë si një model për t'u ndjekur nga të gjitha njësitë vendore.
- Në këto njësi vendore nuk ka një buxhet specifik për kënde lojërash apo për argëtimin dhe përfshirjen e fëmijëve.
- Ndër prioritetet/ nevojat imediate dhe më thelbësore, që kanë nevojë për më shumë fonde dhe vëmendje në buxhetin e njësive vendore, nga të cilat përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë fëmijët është ngritja e një këndi lojërash për fëmijë, rritja e fondit të ndihmës ekonomike, rregullimi i rrugëve, rregullimi i kanalit të ujësjellësit, rikonstruksioni i shkollave, përmirësimet infrastrukturore.
- Përgjatë vitit 2011 është realizuar një studim për buxhetimin në bashkinë Ballsh për lagjen Bylis për ujërat e zeza dhe rrugët, për të cilin ende nuk janë miratuar fondet. Ndërsa në komunën Gradisht është realizuar një studim për rikonstruksionin e shkollës Këmishtaj (17 milionë lekë), preventivi i të cilit është dërguar në Ministri, por që nuk është miratuar ende.

V.Rekomandime

- Maksimizimi i të ardhurave të veta vendore, që njësitë e ndryshme vendore i mbledhin nëpërmjet taksave dhe tarifave në raport me grantet që alokon qeveria, në mënyrë që realizimi i projekteve dhe nismave të ndryshme lokale të mos jetë i kushtëzuar vetëm nga grantet e pushtetit qendror.
- Në përputhje me ligjin në fuqi të decentralizimit, decentralizimi fiskal duhet të zgjerohet në shumë forma, si: vetëfinancimi dhe zgjerimi i të ardhurave vendore nëpërmjet taksës së pronës etj.
- Shpërndarja e financimeve për shpenzime korrente dhe investime jo mbi norma tradicionale, rëndësinë politike apo numrin e popullsisë, por mbi nevojat vendore dhe prioritetet e fëmijëve, të bazuara në statistika, analiza etj.
- Financimi nga niveli qendror duhet të ketë vazhdimësi, njëkohësisht institucionet qendrore sociale duhet të kontribuojnë më tepër në procesin e decentralizimit derisa pushteti lokal gradualisht të ketë mundësinë e ngritjes dhe menaxhimit të shërbimeve sociale.
- Vënia e çështjes së buxhetimit për fëmijë në fokus të agjendës së pushtetit lokal.
- Rritja e fondeve për fëmijët me aftësi të kufizuar në përputhje me numrin e këtyre fëmijëve në secilin rreth. Nga gjetjet e studimit rezulton se numri i fëmijët me aftësi të kufizuar është dukshëm më i lartë në rrethin Fier, më pas në Lushnje dhe në fund në Mallakastër (4 611 në rrethin Fier, 2 743 në rrethin Lushnje dhe 750 në rrethin Mallakastër). Ndërkohë buxheti për fëmijë rezulton më i lartë në rrethin Mallakastër (26 590 lekë në Mallakastër, 14 913 lekë në Fier dhe 14 599 lekë në Lushnje).
- Rritja e fondeve buxhetore për fëmijë në sektorin e arsimit meqenëse fëmijët përfitojnë drejtë për drejtë. Një rritje e fondeve do të shtonte përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe në rritjen e cilësisë. Gjithashtu një rritje të fondeve buxhetore duhet të ketë edhe në fushën e shëndetësisë, si edhe në skemën e mbrojtjes sociale.

➤ Bibliografia

- Buxhetimi me pjesëmarrje udhëzues për pushtetin vendor në Shqipëri (2006), Ekipi i Zhvillimit Social Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore .
- Ligji vjetor i buxhetit nr. 10355 datë 2.12.2010.
- Ligji nr.8379 datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9355 datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22, viti 2005, faqe 829.
- Ligji nr. 3766 datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor” (i ndryshuar), botuar në Fletoren Zyrtare nr. 16, viti 1963, Faqe 312.
- OBSH (2001), Deklaratë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës.
- Programi buxhetor “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe ai profesional”.
- Programi buxhetor “Shërbimet e kujdesit parësor”, “Shërbimet e kujdesit publik”.
- Program buxhetor i MPCSShB “Mbrojtja sociale”, “Shanset e barabarta”.
- Projekt buxheti PBA 2011- 2013, Ministria e Financës, Drejtoria e përgjithshme e buxhetit.
- Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri Unicef.
- Relacion mbi buxhetin faktik 2011, Ministria e Financave, Drejtoria e përgjithshme e buxhetit.
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2004 -2015 e MASH-it, miratuar në 2004.
- Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2009-2013 e MASH-it, miratuar në Korrik 2009.
- Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Shoqërore 2008-2012 e MPCSShB, miratuar në Janar 2008.
- Prefekti i Qarkut Fier “Të dhëna mbi realizimin e investimeve në njësitë vendore, 2010-2011”.

Shtojca 1

a) Çështjet e buxhetimit për fokus grupet me punonjës të ekonomisë dhe financave, Dhjetor 2012

- 1) Buxheti (fondet) nga pushteti qendror dhe vendor për bashkinë/ komunën tuaj si e kanë tendencën në ulje apo në rritje? Si ka ndikuar kjo situatë për fëmijët dhe nevojat që ata paraqesin?
- 2) Si është i ndarë buxheti në bashkinë/ komunën tuaj në lidhje me nevojat që grupe të caktuara individësh mund të kenë? Cilat grupe individësh në nevojë përfshin buxheti? A i mbulon të gjithë grupet në nevojë buxheti në bashkinë/ komunën tuaj?
- 3) Sa përparësi i jepni çështjes së buxhetimit në krahasim me çështje të tjera në bashkinë / komunën tuaj?
- 4) Buxheti me pjesëmarrje është i detyruar me ligj. A zbatohet në bashkinë/ komunën tuaj? Si është procedura?
- 5) Si është procesi i pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes për çështjet që i përkasin fëmijëve në bashkinë/ komunën tuaj?
- 6) Sa është buxheti për kënde lojërash në bashkinë/ komunën tuaj? Po për argëtimin dhe përfshirjen e fëmijëve?
- 7) Në bordin e shkollës a ka një përfaqësues nga bashkia/ komuna juaj (krahas mësuesve, prindërve, përfaqësuesve të DAR-së)?

b) Çështjet e buxhetimit për fokus grupet me punonjës social dhe të politikave sociale, Dhjetor 2012

- 1) Cilat janë prioritetet/ nevojat imediate dhe më thelbësore, që kanë nevojë për më shumë fonde dhe vëmendje në buxhetin e bashkisë/ komunës tuaj?
- 2) Cilat janë disa investime të ndryshme për fëmijët që janë realizuar përgjatë vitit 2011-2012 në bashkinë/ komunën tuaj? Kush i ka financuar? Sa kanë zgjatur dhe si ka qënë pjesëmarrja në to?
- 3) A mendoni se duhet të punohet ende shumë më tepër në lidhje me ecurinë e çështjes së “Buxhetimit” dhe në veçanti të “Buxhetimit për Fëmijë” nga të gjitha Instancat shtetërore dhe jo – shtetërore dhe në veçanti nga bashkia / komuna juaj? Çfarë mendoni se duhet bërë më tepër në lidhje me çështjen e buxhetimit?/ Ide dhe opinione nga ana juaj si përfaqësues i kësaj bashkie / komune.
- 4) Cilat projekte janë realizuar përgjatë vitit 2011 që kanë në fokus mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijëve?
- 5) Ekzistenca e një numri të caktuar të OJF-ve në qarkun Fier a është e mjaftueshme për plotësimin e nevojave të fëmijëve në këtë qark? Cilat do të jenë disa nga sugjerimet tuaja në këtë pikë?
- 6) A është realizuar ndonjë studim për buxhetimin nga bashkia / komuna juaj gjatë viteve të mëparshme dhe gjithashtu gjatë vitit 2011?

c) Pyetësor për buxhetimin e pushtetit qendror dhe vendor, Dhjetor 2012

Buxheti qendror në total për sektorin e shëndetësisë për Qarkun Fier, 2011 000 lekë

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)
A	b	c	d=b+c
Qarku Fier			
Fier			
Lushnje			
Mallakastër			

Buxheti qendror në total për arsimin parauniversitar për Qarkun Fier, 2011 000 lekë

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)
A	b	c	d=b+c
Qarku Fier			
Fier			
Lushnje			
Mallakastër			

Fondet qendrore të MPCSSH B për politikën sociale, Qarku Fier, 2011 000 lekë

	Ndihma ekonomike (000 lekë)	Nr.familjeve përfituese
A	b	C
Qarku Fier		
Fier		
Lushnje		
Mallakastër		

Fondi i ndihmës për PAK, 2011 000 lekë

	Ndihma për PAK total (000 lekë)	Nr. përfituesve total	Nr.i fëmijëve përfitues
A	b	c	D
Qarku Fier			
Fier			
Lushnje			
Mallakastër			

Buxheti vendor për fëmijët në arsimin parauniversitar, 2011 000 lekë

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)
A	b	c	d=b+c
Qarku Fier			
Fier			
Lushnje			
Mallakastër			

Buxheti vendor për fëmijë për shpenzime personeli, 2011 000 lekë

	Shpenzime personeli (000 lekë)	Nr. i punonjësve buxhetorë
A	b	C
Qarku Fier		
Fier		
Lushnje		
Mallakastër		